

VENDIM
Nr. 138, datë 14.4.2023

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGY MARKET ALBANIA” SHPK NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.4.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 877/15 prot., datë 13.4.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 59, datë 24.2.2023 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 25.2.2023 dhe 26.2.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 6.3.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e kësaj procedure u botua edhe në faqen zyrtare të ERE-s.

- Me qëllim shqyrtimin e dokumentacionit të depozituar nga shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 877/5 prot., datë 24.3.2023, dhe vijimin e korrespondencës së nevojshme, me vendimin e Bordit nr. 113, datë 27.3.2023, u vendos zgjatja deri në 20 (njëzet) ditë e afatit të vendimmarrjes së aplikimit të shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k. për t’u licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit dhe dokumentacionit plotësues të aplikimit me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 877/10 prot., datë 31.3.2023, nr. 887/12 prot., datë 12.04.2023 dhe nr. 887/14 prot., datë 13.4.2023 rezulton se shoqëria “Energy Market Albania” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, ghermat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, ghermat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, ghermat “a”, “b” dhe “c” dhe pikën 2.5.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Energy Market Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti